

EQEREM CANAJ

MISTERI

ROMAN

BOTIMET TOENA

EQEREM CANAJ

MISTERI

roman

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Falënderoj piktorin vlonjat Gjon Deromemaj që bëri të mundur botimin e këtij libri. (Autori)

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Recensent: dr. Fatmir Terziu

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Petrina Ago

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-327-02-4

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

Kur burri dhe nata ia grahnin në turr

Kur burri dhe nata ia grahnin në turr, me romanin e Eqerem Canaj "Misteri".

Dr. Fatmir Terziu

Në një prozë të gjatë, natyrisht, së pari syri "shkon" te volumi i fjalëve, mendja mbetet, gjithnjë nëse është për të mbetur, te numri i faqeve që i bëhen detyrim leximit. Dhe më pas e gjitha është një arsye tjetër. Një tjetërsim që lidhet me interesin dhe interesimin e kësaj proze nëse hyn dhe mbetet në shijen tënde të leximit. Me romanin e autorit Eqerem Canaj "Misteri", sasia aritmetike, po aq dhe numerikja e faqeve në dorëshkrim, u zvenitën që në kapjen e parë të syrit dhe kërkuan të mbeten gjatë, për aq kohë sa mendja dhe dora u bënë një me penën e këtyre rreshtave. Dhe menjëherë sytë, mendja dhe dora nisën të pikasin atë që dallohet në mesin e një morie fjalësh. Dallesa shkon te sita e sitimi i materialit, që autori e ka bërë gati për lexuesin. "Lexuesi", ndoshta me fat, nisi nga këto shënime, të cilat gjetën fjalën e bukur, atë që e bëri "lexuesin" të dallojë në këtë narrativë.

Ndërsa fjalët janë arsye më vete, edhe emërtesat narrative, karakteret, ata që hyjnë në sitën e narrativës, kur kapin emra të tillë si “avokati Çedon” bëjnë atë detyrë që kërkon syri i lexuesit, të mbetet mes faqeve dhe të depërtojë diskursin e emërtesave, kuptimin që sjellin e përcjellin fakte të tilla strukturore të emëruara nga autori i prozës. “Çedon” vërtet mbetet një i tillë në kuptimin e parë të emrit, siglimit të tij, shënjes dhe si shënjes mbetet njëfarë më shumë në fushën narrative për të prurë ndihmë në frutin e tejtejshtëm të narrativës. Biznesmenët Zhyvene dhe Pavlind kanë një arsye tjetër në këtë narrativë, po kaq sa deri në fund të leximit, narrativa i nxjerr në shoshën e dritës, që mbulon diellin në qytetin e trazirave. A mbulohet dielli me shoshë? Këtë do ta kuptojë, jo si një urtësi populllore, Gjon Dorani, një nga protagonistët e romanit, por si një arsye semantike dhe filozofike e diskursit, ku në ngjarjen e dhimbshme e mjaft delikate, që ushqen narrativën dhe mesazhin e romanit “... kishte qenë vetë ai polici i liruar, i cili pati pritur në skelën e qytetit biznesmenët e huaj, Zhyvenen dhe Pavlindin”. Por kjo vjen në fund të romanit, si një arsye për të përforcuar diskursin e emërtesave, shënjesin dhe signifikativën tek e vërteta: “... ata ishin shqiptarë, shokët e monstrës, që tentuan të arratiseshin nga gardhimi. Në fakt, ai, i mbeturi shkrimë në tensionin e lartë, kishte qenë roja i burgut. Dy të humburit qenë kapur e dënuar sërish. Kohë më vonë patën bërë tunel nga burgu e në buzdet, prej andej e në shtetin fqinj. Qendra, duke ua ndërruar identitetin, i ktheu sërish

për një lidhje të re. Dhe ata, nga ç'u panë sytë, ikën siç erdhën". Kjo është zgjidhja e një enigme, që nis me ata që kishin "bredhërirë botën", pra me biznesmenët e narrativës, që zbresin si "të huaj nga anija" pikërisht aty "në skelën e qytetit bregdetar, porsa nata kishte lëshuar bërrucin e zi e të thuktë".

Nata që krrakërrinte në qytetin e thellë, shërbimi i posaçëm i tyre, udhëzimet nga qendra, pulëbardha që gëlltiste ujërat e kripura dhe jepte shpirt papritur, fundjehona nxi e këtij qyteti, gjendja amorfe, qielli i plumbtë, hataja, nuk është se kanë vënë ndonjë ndryshesë në sytë dhe vëzhgimet e "biznesmenëve të huaj", por kanë vënë në lidhje gjithashtu përfundimin se të tëra qytetet ngjasonin aq shumë me njëra-tjetrën, siç ngjasonte vëllai me vëllain, me motrën a kushëririn, përveç madhësisë, lulëzimit e të tjera. E veçanta është gjeografike, e falur moteve, e ardhur dhuratë dhe ajo nuk mund të njësohet, se aty mbetet era jonike, që dyndej pikërisht në këtë gji, ku qe ngulur përjetësisht qyteti, por edhe atë maloren që preverte nga malet Akrokeraun, si dhe duhmën e portokalleve, limonëve, mandarinave, ullinjve. Tek këto veçori drynoheshin sytë. Kaq mjafton të hysh e të kërkosh thellësinë e narrativës në një qasje të bukur, të thjeshtë e të mirëzgjedhur të autorit. Më tej narrativa shkon shkitazi, ana linerare e saj, forma rrëfyese, gjuha e qartë, arsyetimi në këndin e parë, syri rrëfimtar dhe vëzhgues, ndjekja e qartë e problemeve, rreken të bien në një strukturë të ndjeshme e tërheqëse.

Teksa këmbët e biznesmenëve "hëngrën asfalt mbi portin detar", ajo që kapin sytë pas xhamave të

makinës mbetet në thelb dhe pika ku fillon referimi. Të dy janë të shtangur. Janë në prirje të përcjelljes së atij qeni, që shfaqet disi ndryshe nga qentë e sojit të tij. Dhe fjala e parë pos pamjes është “Do ta vras atë qen të ndyrë! Do ta fus mes rrotave!” Kjo nuk ndodh, por shfryhet. Shfryhet se, “një qen me një dorë njeriu në gojë, i cili ia grahte në pikë të vrapit porsi shigjetë dhe s’e lëshonte prej goje dorën e përgjakur me gishtërinjtë e kalivarur” kishte hyrë tashmë në eksklamacion. Ata shtangën, ngrinë në vend. Nuk mbetet vetëm “beftia e rastit, por tronditja që i pati ngërthyer dhe, ca më tej, pamja e shoferit, i cili ndryshoi çehren e fytyrës shpejt: u skuq, u nxi, u zverdh, sikur u shndërrua në bishë. Duke u turrur, ai dredhoi timonin në përndjekje të atij qeni të shpifur”. Aty diskursi rreket të gjurmojë në narrativë, të kuptojë atë të flamur “luftë civile” gjasme, tashmë në shekullin XXI.

Por, kjo tashmë kuptohet se është vetëm fillimi, e nëndheshmja, ajo e padukshmja. Pra ajo që në çastet e vetmisë, kur ta vinin punën në vijë, do të shërbente që “t’ia qëndisnin qendrës në një raport të detajuar: ‘Qyteti i Trazirave dhe i të mbijetuarve’...”

Dhe vërtet, pas diktimit të vetë emërtesës “trazirave” qasja rrëfen faktet nga hoteli, maskat e zeza që kontrollojnë dhe tmerrojnë, zhdukjen e njerëzve, dilemën për ekzistencën e avokatit Çedon, e folura për katrahurën, dhe më së shumti për daljen në skenë të Gjon Doranit. Në narrativë “Gjon Dorani është pika që pikonte, pikë floriri, thonin”. I kapte të dyzetat, nëse shihej nga afër dhe ndaj, referuar atij, pra

Gjon Doranit, njerëzit me mend, patën nënvizuar se, në dyzet vjet, mashkulli quhej burrë. “Gjithnjë duke kaluar këtë cak, sepse aty ndaheshin burrat, burrecët, mistrecët, kastravecët, karkalecat, qaramanët, laramanët (burrë-grua) derdimenët, delenxhinjtë, dënglaxhinjtë, sherrxhinjtë, gomarët, pykat, rripat, qypat, maskarenjtë, zagarët, kurvarët, imoralët, rrufjanët, servilët, xerxebilët, spiunët, majmunët, firaunët, hajduti, muti, malukatë e baltë.”

Për autorin, po aq dhe për lidhjen në narrative “Gjon Dorani qëndronte në vijë kufiri. Kish të vetat, edhe ky: spërklat e ujit të rrjedhur...” Ndaj dhe i jepet më shumë rëndësi në qasjen narrative: “Posa mbaroi gjimnazin e qytetit me përparim shkëlqyeshëm, të riun sykaltër e pritnin rrugë të reja. I ati, burrë me emër të mirë, një oficer lufte, dalë në pension, e cyti të birin që edhe ky të vazhdonte rrugën e të et. E thënë, e bërë! Familja sytë i drejtoi te perspektiva e tij. Dhe ai nuk i zhgënjeu: mbaroi shkollën ushtarake në kryeqytet, u diplomua si student i shkëlqyer. U ra kufijve kryq e tërthor, gjithnjë me përkushtim e la emër dinjitoz. Pas vdekjes së të atit, nuk di ç’mendje i erdhi, e la detyrën ushtarake e u hodh me Rendin. Si e qysh, përfundoi oficer drejtimi në shtëpitë e vuajtjes, në qytetin e lindjes. E, kur përballej kush me të në ndonjë kafene, ky shprehte kënaqësinë e këtij përfundimi. Natyrisht, i martuar, me shtëpi e grua që përshtateshin, makina lustër, me të ardhura të mjaftueshme, me shoqëri të rangut e me perspektivë të një kufiri normal, as i pari e as i fundit i qytetit”.

Narrativa përkujdeset mirë në detaje dhe e afron leximin më afër interesit të narrativës. Zejdin Brinja ling pos hakmarrjes, ezmerka ushqen lidhje të tjera, vejania ka arsyen e vet, gruaja dhe vajza e avokatit Çedon janë në një kënd tjetër, ndaj autori kërkon të sqarojë mes vetë qëmtimit të atij realiteti dhimbanak: “Atë botë, të dy trupat, kishin rënë në kllapi, pa as më të voglën lëvizje, asnjë fjalë. Heshtja e ankthit bënte të vetën. Shtoi pas pak njeriu i natës: Shtrydhe, moj jevgë, policin e qytetit bregdetar!”. Shthurja tashmë nuk njih ligj, nuk ka arsye, nuk ka uniformë, nuk ka shtet, ajo është e gjitha grup më vete, fuqi dhe ligjësi më vete. E gjitha është anarki. Ndaj Gjon Dorani lë pas gjeografi të ndjeshme dhe kapërcen përtej detit. Gjon Dorani, kadalësisht, hyn në një botë tjetër. “I kalonte oficeri i liruar nëpër mend të tëra, çka përbënte gjirin e pranverës brenda asaj toke me emrin ‘Shqipëri’... Po ngutte diku: te vetvetja, brendësia... Qëllimi i asaj lëvizjeje i kishte rrënjët brenda trurit të tij, në damarë, në palcë, në gjak, në gjithë qenësinë e burrit. Po tek ai njeri i panjohur, i cili vazhdonte të hapte varre mbi trupin e qytetit, vendlindjes?”

Gjon Dorani pa se në një gazetë: “Corriera della sera”, nënvizohej se njëri prej tre kriminelëve pati shpëtuar mrekullisht dhe se vazhdonte të vepronte në thellësitë humane të një qyteti bregdetar... Kjo e dhënë puqej katërçipërisht me faktet që dinte apo që zbulonte, herë-herë, oficeri i liruar. (Shumëkush e kishte cilësuar shëtitari i pafat). Eh, ç’rëndësi, mendonte, duhej të takohej me ministrin e Rendit, kjo dhe pikë!

Atje do të shkoqitte dyshimet, analizonte faktet, do të argumentonte për një plan domosdoshmërisht të zbatueshëm, ku do t'i buzëqeshte një fitore. Ja pra, të tilla kuinta qenë ngulur në katrahurën trurorë të tij. Pjesa në vazhdim është udha më e dhimbshme. Aty shpërthen tërë thelbi i shthurjes, katrahurës, e vetë thelbit të dhimbjes. Gjon Dorani, Lira, Beneta, Erikë Saraji etj. nuk janë thjesht në një lidhje me “engjëllin e ditënetëve”, por si formula enigmatike e zgjidhjes së mozaikut në narrativë: “Lira është kurvë apo jo? Sa dashnorë ka? Përgjigju shkurt, shpejt! Erika uli kokën dhe u shkreh në lemeri vajtimi: Zejdin, ç’të kam bërë unë?”.

Dhe enigma mbetet në narrativë. Sa për të shkuar te më interesantja, “Gjon Dorani, oficeri lirimtar, të kujton njeriun me ombrellë, të cilin rrufeja e godet tmerrshëm, pamëshirshëm. Ndërsa ai ndjek udhën e gjarpërinjve të vetëtimave në qiellin mavi. Gjarpërinjtë e lënë shfaqjen vetëm ca çaste, pastaj zhduken aq shpejt sa krijojnë iluzionin e shkaktuar nga drithërimi i çastit, kësioj bëjnë mashtrimin për goditjen befasuese. Avokati Çedon u gjend, kur, sapo pati vdekur harresa. Dhe u derdhën lot e vaj në shkretirën e buzëdetit: u shtrydhën deri në kufirin zero dashuria e dhimbja. U njoftua komisariati i Rendit, avokatia... U dërguan ekipet e verifikimit, ekzaminimit, mjeku mediko-ligjor. U fotografua gjithçka në imtësi, u filmua dhe u arrit në përfundimin e identifikimit: skeletit të avokatit Çedon Saraji, rrëmbyer nga një dorë e padukshme, vrarë e varrosur në rërën e

bregdetit, i mungonte një krah, i djabat. Gjene, trupi u përçoll për në morgun e spitalit me porosi, çdo gjë u krye më së miri. Po edhe pa bujë. Qe një ngjarje e vonuar, që tregonte paaftësinë e institucionit, shtetit demokratik... Vendimi, se arkivoli me trupin e avokatit do të vendosej në një sallë të komisariatit apo të avokatisë, për t'iu bërë nderimet zyrtare, u hodh poshtë. Kishte qenë fjala e zëvendësministrit të Rendit që i kishte vënë vulë përpëlites së gjithkahshme”.

Në romanin “Misteri” mosekzistenca pjell joekzistencën dhe njeriu është ai që kërkon në kotësi jetën e tij të kotë. Qentë bëjnë punën e tyre në këtë anarki, dhe sjellin idenë e frymëzimin të rrëfihen me dorën e njeriut në gojën e tyre. Këtu shfaqen fuqitë e shkrimit, ajo që prodhon mendja në një realitet të dhimbshëm. E kështu, duke e përfunduar me fjalët e shkrimtares britanike, Jane Austen “Një roman... ose, me pak fjalë, vetëm disa vepra në të cilat shfaqen fuqitë më të mëdha të mendjes, në të cilat njohja më e plotë e natyrës njerëzore, përcaktimi më i bukur i llojeve të tij, rrjedhjet më të gjalla të zgjuarsisë dhe humori, i përcillen botës në gjuhën më të mirë të zgjedhur.” Le të shpresojmë se edhe lexuesi i lirë, i ndjeshëm dhe i qetë do ta mirëpresë këtë narrative si të tillë, duke lënë pas vetëm qentë, ata që gjithnjë, në njëfarë mënyre, e në një tjetër, kërkojnë të mbajnë në mes të dhëmbëve duart e njerëzve.

Të huajt zbritën nga anija, në skelën e qytetit bregdetar, porsa nata kishte lëshuar bërrucin e zi e të thukët. Ishte një shërbim i posaçëm i tyre, ashtu siç edhe patën marrë udhëzimet nga qendra. Në po ato çaste, ata e ndien si krrakërrinte nata në qytetin e thellë, ashtu si pulëbardha që gëlltiste ujërat e kripura dhe jepte shpirt papritur. Ishte fundjehona nxi e këtij qyteti, pas trazirave të kohëve të shkuara. Dihej se prej atyre trazirave në këtë qytet bregdetar ishte krijuar një gjendje amorfe. Nën kupolën e atij copë qielli të plumbtë ishte bërë hataja. “Qyteti i Trazirave” e quajtën të huajt, ndryshe nga emërtimi i vendalinjve, të cilët krenoheshin me bëmat e bëmatarët e çdo kohe.

Të paraqitur si biznesmenë, ata nuk ishin njerëz sido, thuajse kishin bredhërirë botën dhe patën arrirë në përfundimin se të tëra qytetet ngjasonin aq shumë me njëra-tjetrën, si ngjasonte vëllai me vëllain, me motrën a kushëririn, përveç madhësisë, lulëzimit e të tjera. Po, për këta, ky i famuri qytet dukej ndryshe:

kishte edhe erën jonike, që dyndej pikërisht në këtë gj, ku qe ngulur përjetësisht qyteti, por edhe atë maloren që preverte nga malet Akrokeraun, si dhe duhmën e portokajve, limonëve, mandarinave, ullinjve. Po, mbi të gjitha, binin në sy, ca si tepër, palmat. Ato gardhonin qytetin, rrugët, bulevardin, që nga sheshi kryesor e deri në skelë, aq sa kur frynte erë gjethet e palmave ankthonin tërë qytetin, duke e mbyllur brenda një trishtimi, çka ndillte mort. Kjo gjendje dukurie u ra në sy të huajve qysh në kontaktin e parë. Dhe, në vend që të ndikonin pozitivisht në ndjenjat e njëri-tjetrit, përkundër, u drynuan secili brenda vetes.

Trageti, me të cilin patën udhëtuar ata të dy, mbërriti vonë, gati në muzg të atij moti me erë e sqotë. Ishte, ky, një qytet me klimë mesdhetare, gjithçka qe e pranishme, thuajse nga çasti në çast. Ata ndiheshin të shqetësuar. Dhe u dukej vetja se ndodheshin në humbëtirë, në fundin e një bote, thuajse të egër, me një dukuri egrane. Ndaj edhe u bënë nervozë aty për aty. Thellë deti gjëmonte dhe malet e egra e të frikshme kërcëllonin prej gjakime vetëtimash, ndërsa dallgët gëlltitnin rërë vazhdimisht.

Teksa këmbët e tyre hëngrën asfalt mbi portin detar, e para gjë në mendje u shkoi për hotelin. Donin të futnin kokën brenda, pa të nesërmen, me të parë e me të bërë, mendonin. Po atë çast, fatmirësisht, disa

hapa larg portës, sytë u zunë një taksi, si e stacionuar enkas për ata të dy. Zhyveni s'priti më, menjëherë vrapoi duke lëshuar një pickamë, a thua se e kishte pickuar gjarpri. Ndërkohë shoferi i automobilit, që e kuptoi se ç'kërkohej, ktheu kryet andej nga i erdhi zëri, duke u buzëqeshur dashamirësisht. Zhyveni dhe tjetri, Pavlindi, çliruan frymë dhe i përcollën djaloshit zeshkan buzëqeshje të sforcuara, si të ndrydhura brenda një trishtimi që as vetë nuk po e kuptonin. Vrulluan pa fjalë, sistemuan baulet në bagazhin e automobilit të zi dhe sakaq zunë vendet.

- Të lutem, mund të na ndihmoni për të siguruar hotel? - foli Pavlindi, duke krijuar paksa, një situatë të besueshme. Qe, ky, një thatanik, i hollë e i zbehtë, me syze miopi, midis të pesëdhjetave a kusur. Të folmen e kishte të qetë, paçka se përfshinte në vetvete tone dridhëse, të befta a shtangie të pakuptimtë.

- Ndonjë vilë? - ia ktheu shoferi korrozi, me fytyrë të rrumbullakët e vështrim vezullues, me një ngathtësi të shtirë, disi i vërejtur e fjalëpakë.

- Po të mundeni, - pasoi Zhyveni, i cili duhej të ishte më kryesori nga të dy. Kaq, gjithçka do të shkonte vaj, menduan rrufe si njeri e si tjetri. Prapa mbetej deti kaltëri në terr, rrudhur prej dallgësh ndër hone, që mbytnin vetveten dhe sajonin retorikën e fushës së pamat. Zhyveni së bashku me Pavlindin po bujtnin në këtë qytet për të ngritur të parët kompaninë e

fuqishme të tyre e për t'i hapur udhë drite eksport-importit të munguar... Gjithaq, mendonin, kishte kohë të mjaftë për kthjellim. Këngëvaji i detit të asaj mbrëmjeje dhe dashkëndja e njerëzve u dukej diçka më tepër se mirëseardhjeje. Bukur! Por, në po ato çaste, ndodhi beftia shëmtake.

- Maskarallëk! O njeri, o dreq! - bërtiti shoferi korrozi dhe gati gjekëti në humnerën përbuzë detit. E papritura që ankth dhe tmerr, siç edhe e gjykuan pasagjerët, teksa frika i tulati keq. Ata nuk po e kuptonin realisht se ç'po ndodhte midis Korroziut dhe qenit rrugaç. Ndaj ndërhyjnë te shoferi thuajse për inerci:

- Ç'ka nja ashtu, bre?! - deshi të shtynte më tej i huaji që ishte më pranë, por nuk arriti. Korroziu nuk përmbahej:

- Ky qen larash me atë dorë... Nuk e sheh?!

- Çfarë, mos po më gënjejnë sytë? - Zhyveni brofi përbri shoferit që, atë moment, duart po bënë lakadredhë instinkti mbi timon. E, megjithatë, ai s'po ua varte dhe aq të huajve. Shkrumbëzonte përbrenda gjithë tallaz, diç shau, pështyu kah rruga, u rrëqeth, hakërriu dhe bubulliu sakaq.

- Do ta vras atë qen të ndyrë! Do ta fus mes rrotave!

Të huajt, nga llahtari i shfaqur: (një qen me një dorë njeriu në gojë, i cili ia grahte në pikë të vrapit porsi shigjetë dhe s'le lëshonte prej goje dorën e përgjakur me gishtërinjtë e kalavarur) shtangën, ngrinë në

vend. Nuk qe vetëm beftia e rastit, por tronditja i pati ngërthyer dhe, ca më tej, data e shoferit, i cili ndryshoi çehren e fytyrës shpejt: u skuq, u nxi, u zverdh, sikur u shndërrua në bishë. Duke u turrur, ai dredhoi timonin në përndjekje të atij qeni të shpifur dhe gjithnjë mërmëriste: “Qeni... Dora... Dora perverse”...

Zhyveni, i cili e mori me mend zhvillimin, iu lëvdua Korroziut:

- Të lutem, zotni! - duke ia hedhur dorën në timon, ia përfshiu fytyrën brenda asaj ndjenje revolte, drynimit, ngathëtie dhe frike njëherësh.

- Ç’do të thoni? - zeshkani, ndërkohë, vazhdonte të ndiente goditje të shpeshta nën brinjë, si një gulfim i brendshëm për nxitje.

- Të mbarojmë së bashku. Ramë dakord të na çonit në një hotel...

- Ju s’mund të na lini në rrugë, - ndërhyri tjetri, Pavlindi.

- Ashtu?! - shoferi pyeti dhe bëri të çuditurin njëherësh.

- Më duket se është e natyrshme, mandej mund të merreni me qenin a me djallin, - vazhdoi tjetri më qetë dhe gati me zë lutës.

- Oh, më zutë ngushtë! - u ankua Korroziu. - Ai qen duhet vrarë, a e kuptoni?

Në harkun e cakt të shkallinës së tij, ai riktheu sërish timonin në drejtimin ku pati synuar qysh parë, iu bind të huajve pavarësisht si, qysh a tek, pasi bëri ndonja pesëqind metra rrugë buzës së detit, preu më

të djathtë, qëndroi para një ndërtese dy-trekatëshe, i zbriti pasagjerët e mbrëmjes, duke u treguar fasadën e hotelit dhe shkarkoi baulet e tyre në rërë. Hyri vrulltazi në kabinën e makinës dhe ndezi motorin shpejtësisht, gjithë i nervozuar ia futi marshin dhe nisi për andej nga po lehnin e angullinin qentë grindavecë të asaj nate qorre. Zhyvenin dhe Pavlindin po i pushtonte paniku. Krejt pavetëdijshtëm kuptuan se qyteti ende drithërohej brenda guaskës së vetvetes. Ajo e flamur “luftë civile” gjasme, tashmë në shek. XXI, paskësh qenë vetëm fillimi, e nëndheshmja, domethënë ajo e padukshmja vërehej se do të qe më e tmerrtë, e tejzgjatë, siç edhe e përdornin “Dardha e kishte bishtin prapa”... Asisoj po mendonin në çastet e vetmisë, ndërsa, kur ta vinin punën në vijë, do t’ia qëndisnin qendrës një raport të detajuar: “Qyteti i Trazirave dhe i të mbijetuarve”... Ndofta edhe për atë dorë perverse, që u shfaq sapo shkelën këmbët në tokë.

Atëbotë ankthi po i ndiqte, si ndjek hija trupin nën arin e hënës. Edhe pse, pa vështirësi e telash, rezervuan një dhomë me mobilim të thjeshtë në hotelin që porsa bënë ballë. Lodhja dhe zdërhalla e çasteve i kishin drynuar brenda përbrenda, pra, ua fashiti zërin, hovin, çiltërinë dhe hokanë, që i karakterizonte sa herë që hynin në një qytet të ri. Po ajo natë e vonë, e cila kishte rënë turthi, e rëndë dhe e sertë, zhdukuri prej tyre të vetmen gjurmë të asaj laure ndriçimi të çasteve të para, posa shkelën këmbë mbi skelën e qytetit. Shfaqja e atij qeni, e dorës së atij fatkeqi... Dhe portreti i shoferit korrozi, që ndryshoi aq papritur,

qenë gozhdë të ngulura në trupin e tyre, në kraharrorë, brenda mu në zemër a tru.

Hotelxhiu, ai plak i rrudhur, paksa i kërrusur, i shoqëroi deri te dhoma e fjetinës, diç mërmëriti nëpër dhëmbë, tërhoqi derën prapa dhe u zhduk në të ndarën e vet, ku zhurmoi mbi shkallët e brendshme të atij hoteli të ftohtë, buzë detit zulmëmadh. Palmat e qarkonin godinën e tij si gjarpërinj të frikshëm, gjethnajat e të cilave goditnin ritmikusht si trokitje në ndërgjegjen e tyre të çakorduar. Ato dukeshin shtatlarta, degët e shtyra prej erës çukitnin dritaret, ballkonin, dyert e të gjitha faqet anësore të myshnjosura nga blertaja e myshqeve të shirave vjeshtake. Dukej se edhe ashtu ankthonin platformën e betontë, duke qarkuar fasadën brenda një litari ankthi. Ishte konstatimi i parë në sytë e tyre, si qenë deri aty: të pangrënë, të lodhur deri në drobitje, pa pikë gjumi në sy nga ç'ka ngjasa në beftinë, që i pati marramendur. Ishte zhguni i natës terrinë, depërtuar brenda fishkëllimës së gjarpërinjve të shiut. Pa pikë, pa presje gjer aty ishte apo kishin kaluar një torturë nervore, çka lidhej paksa edhe me historinë e atij qeni dhe shumëçka me të papriturat që mendonin se edhe mund të qenë të pranishme në ditë-netët e vijimësisë.

Ndërkohë u dhanë mendimeve fund: do të flinin për ta mbledhur veten, që e nesërmja t'i printe drejt punëmbarrës. Por nuk u bë, sepse nata vrastare, me atë dorë njeriu në gojë, hyri tërbimshëm në gjendjen e

krijuar e ua vrau gjumin po aty. Dhe, ja se si. U dëgjuan hapa njerëzish në shkallinat që lidhnin katet, si dhe zëra nga bisedat e çrregullta të atyre që po ngjiteshin në katin e sipërm. Ndërsa po kuptonin se gjurmët afroheshin korridorit, e gjer te dera e dhomës së tyre. Heshtje ankthi. Dhe, përsëri, biseda të pakuptimta. Të porsasistemuarit dëgjonin me ethe në kurriz, më saktë pritnin vdekjen pa ulëri. Dera trokiti dhembshëm. Prapë e sërish, pastaj me forcë...

Zhyveni u ngrit i pari, ashtu në brekë siç u ndodh, i dridhshëm, kërkoi çelësin e dritave, por më kot. Ato qenë shuar me rrënjë, besoj, në tërë atë zonë a i gjithë qyteti natar jetonte në pellgun e tertë. Kur e kur, jashtë shiu breshëronte mbi xhamat e dritareve. Dhe, me po aq breshëri, ca duar qëllonin me ngut mbi derën e dhomës së tyre. Ndërkaq Pavlindi shtyu tutje batanije e çarçafë dhe u lëshua përpara me llahtari. Ndërsa, pa arritur që duart e të kërcënuarve të kryenin ritin e çelësit në bravë, dera e shkallmuar u ra në gjoks. Një burrë me maskë të zezë hyri brenda si bishë. Dukej katallan: i gjatë, i zi, i frikshëm. Në harkun e vetëtimës, që rrymëtoi dhomën, të pambrojturit u bënë të gatë përpara njeriut bishë, kur tjetri, dytësori i tij po i maskuar, ruante lëvizjet në korridorin e ngushtë.

- Pse nuk e hapni, derra?! - ulëriu qenia e frikshme me trup njeriu, ndërsa po u rrihte fytyrën me prozhektor dore.

- Nuk mundëm, - bëri të shfajësohej Zhyveni.

- Ne jemi të huaj, tregtarë, - donte të sqaronte Pavlindi, po foli në veshë të shurdhër.

- Portofolat mbi tavolinë, - njeriu i zi, me dy revolverë ndër duar, ua drejtoi armët drejt fytyrave që lebetiteshin në drithëri.

Ndërçast, këta i kërkuan mundësinë e të lëvizurit dhe po ashtu dridhshëm, nxorën e hodhën në shesh portofolat me dollarë. Po, ende pa u marrë në dorëzim prej katallanit, prapë gjëmoi zëri i tij:

- Dokumentet të gjitha, shpejt! - atëherë, fare pa kundërshti, u realizua edhe detyrimi i dytë. Bastardi fryu xhepat hem me pare, hem me dokumente të ndryshme: kartë identiteti, pasaporta, karta-vize, leje qëndrimi, bileta udhëtimi e më the e të thashë.

Të kërcënuarit mbetën me gisht në gojë. Por çudia pasuese i befasoi edhe më tepër, se si ata që i batërdisën kishin makutëri jo vetëm për pará. Kuptohej se të tillët mund të mos qenë thjesht hajdutë xhepush, por, ndofta vraparë... Njeriu, që i sulmoi, vuri në brez qetësisht njërën pistoletë, pasi i shtyri me fytyrë krahëhapur për muri këta të dy, rrëmbeu nga tavolina stokun e lëshuar frikshëm, i rregulloi sido në xhepin e një mushamaje të zezë, ktheu vrull, tërhoqi derën me forcë; në pak minuta bëri gjithçka. Për më tej, u dëgjuan zhurma hapash, duke zbritur ndër shkallë, pastaj, gjurmë fjalësh të pakuptimta. Dhe, së fundmi, u shquan dritat e një automobili, duke ndriçuar rrugën që zbriste në

buzëdet. Kaq, pastaj rrymëti mendimesh po vrujonin në kokat e nxehta të të mbeturve hutaqë.

Deti troshitte e përplaste dallgë të tërbimta në breg. Ndërsa të dy fakirët, (tashmë u kishte rënë hunda përdhe) kur u bindën se bastardët kishin lënë prapa hijen e përbindëshit, liruan vetveten gjer në shkordhje, siguruan disi derën e dhomës, afruan shtretërit pranë e pranë dhe kllapuan duart e njëri-tjetrit, si të vetmen fortesë në amullinë e ngrirë të asaj gjendjeje shpirtërore. Nata zdryqte dhe ndëshkonte tokën në gjithçka. Natë e mbrapshtë e njerëzve me maska. Dhe një qen. E dora e njeriut në dhembët e qenit. Në gojën e natës gjithashtu. E natës së qentë. Dhe burrat me maska. Dokumentet... A nuk qenë dollarët më të rëndësishëm për sulmuesit?! Interessantë. Në ligatinën e zezë lëvrinte diçka: lavra tmerri brenda turbullirës. Dhe mendime të shthurura vërtiteshin në lemerinë e pacak. Ca kuaj të azdisur kafshonin njëri-tjetrin dhe vetveten njëkohësisht. Të gjitha brenda natës trurorë, trazira e pafund e qytetit dhe e qytetarëve, të cilët ishin pajtuar me vesin. Mendonin të huajt e kamufluar se si mund të gjenin një tjetër zgjidhje, pra fjet...

E nesërmja e gdhirës, jo vetëm ua hapi sytë, por edhe mendtë paksa. Ndryshku pati mbuluar ca gjasa të hekurta. Kishte përfunduar një luftë midis bandash, të drejtuara prej një grupi politikanësh të sëmurë nga ethet e karriges, fillesë e një lufte civile, e cila kishte

zgjatur vetëm disa muaj, ku qyteti qe rrahur edhe nga grykat e topave e të mortajave, pra ishte një njollë e zezë në faqen e bardhë të qytetit bregdetar. Shpikësit, që kërkonin frenat, i patën marrë. Paskëtaj ia patën vënë vulë gjithçkasë. Gjene. Si tregonin shenjat, bishti i gjarprit rrotullohej rreth vetes: ai vërtitej, përpëlitej, gjakohej, tërbohej e klithte llahtarshëm.

Njerëzit-bishë, pra ata me maska të zeza, flitej e kuptohej ashiqare se e patën bërë qytetin plot dora, duke ia vënë të dyja këmbët në një këpucë. Dhe gjasat e zeza përbënin retorin e zakonit në qytetin e trazirave... Siç edhe mësuan se kërkohej një njeri i humbur, avokati Çedon Saraji. Për së fundi qe hapur fjalë se një skelet njeriu qe gjetur në rrëzën mes pishave të buzëdetit. Përflitej se njeriu mund të qe groposur cektë ose jo... Një qen ia pati këputur krahun. Ndofta e patën përzënë njerëz a qenë të tjerë, ndërsa ai vrujonte buzëdetit të rërtë, në pikë të vrapit, pa e lëshuar dorën nga goja. Ndoshta e pati mësuar skandalin e radhës edhe shoferi i taksisë, Korroziu, i cili, sa e diktoi qenin atë mbrëmje, vendosi ta zhdukte, ta vriste atë larash që po hapte plagë të reja në qytetin e tkurrur nga dhembjet e njëpasnjëshme. Sipas të huajve, Korroziu qe djalë i zgjedhur me dorë: trupgjatë, paksa trung, zeshkan, i vrazhdë në fytyrë, mbante veshur një xhakavento lëkure të zezë... Zhyveni mendonte rrufe: një njeri i vvarë... Nata ia grahte në gjurmë të

gjematës... Një dorë njeriu në gojë mbante ajo natë. Në dhembët e qenit kërcisnin gishtërinjtë e hollë...

Sipas këtyre të dyve, avokati Çedon Saraji do të qe, ose jo, viktima e fundit, kjo ishte çështja. Fijet... Por, si dukej, s'do të kishin më vend në këtë qytet. Dita e porsambërritur po u thoshte: nga vutë majat, vini thembrat. Katrahura ishte e ftohtë. Frynte erë.

Duhej të qe ditë e martë, ditë prilli, ku natyra ringjallte vetveten me bukurinë e paparë, si dhe njerëzit në tërësi, të cilët frymonin ditët pa arritur tek individ. Sidoqoftë, në dukjen e parë, flitej për gjuhën e katrahurës. Secili arsyetonte, grindej me vetveten a me ndokë krejt pa shkak. Dhe përdorte fjalë pa vend, gjer në ndyrësi. Mundet edhe të mos jetë tamam ashtu, por u arrit në këtë përfundim ndoshta nga kahpamja. Edhe mundej. Dikush po cyste mendimin në një udhë të pacak. Dhe e gërryente nga brenda si krimbi mollën. Dhe s'i jepte dot dum. Ishte diçka tepër e rëndësishme, përbiruese, dominuese, gjer në tundim. Gjë që Gjon Dorani nuk e kishte të lehtë.

Sapo lëshoi këmbë mbi bulevard, vështroi motin, rrjetkën e hollë gati të tej pamtë, që mbulonte atë kupolë qielli mbi qytetin bregdetar. Natyra i dha atij një ndjesi shpëlarjeje. Do të thoshte: dielli i mëngjesit nuk të

ngrohte, nënkuptohej se ditëvazhda do të qe e lakuriqtë, e pakënaqshme, dhe formuloi mendimin se syri s'ë dëftonte hijen. "Heee", - shtoi po atë çast, mbroçkullat e së kaluarës me ngjasat e së tashmes priteshin në një pikë, ato nuk ecnin paralel me njeriun. Përkundër, jetonin brenda e jashtë tij: qenë miza që thithnin mbi qenien, tmerrshëm e vazhdimisht, kur kishin të bënë me gjasa rrënimi, si vetvetja e rrëzuar në hon.

Ai çapiti në kryqëz të udhës së bashku me dalldisjet e çasteve e me shkumbime valësh në tërbimti. Automobila shpejtësie po ia prisnin rrugën, gjithçka dukej se po zhvillohej me kast. Kështu e para, e dyta, e treta, e pesëmbëdhjeta. Thoshin se në qytet kishin zbritur udhëheqësit... Paçka, ndonjë ditë feste, mendoi aty për aty. Pastaj arriti në një tjetër përfundim: nuk paskëshin qenë automobila ata që përshkonin rrugën e as udhëheqës, as ndonjë ngjarje turbullire në qytet. Asgjë s'paskësh qenë, vetëm vegime, iluzione të një truri të çakorduar, të një trupi të lektisur që s'dallonte dot vijat e bardha mbi rrugë, aeroplanin që kafshonte qiellin, që s'dëgjonte dot fishkëllimën e bilbilit të policit, që s'dëgjonte as rrokamën e një reaktivi, që thyente degët e palmave mbi kokën e tij. Se automobilat i kishte brenda në tru, madje edhe "Rrugën e Palmave" e kishte po ashtu, me gjithë kalimtarët e zakontë, pa pikë mëdyshje, edhe zhaurimën e reaktivit dhe kërcitjen e gjetheve, të gjitha brenda kafkës, çka e shurdhonin. Edhe aparatin e ekspresit, tek gatuhej kafeja e mëngjesit, atje te lokali i ezmerkës.

Gjon Dorani ishte pika që pikonte, pikë floriri thoshin. Kishte lindur aty, në qytetin bregdetar, nuk dihej ç'viti i përkiste. Që të afroheshe paksa, do ta vendosje midist të dyzetave a përmbi. Duke ditur se çdo gjasë kishte logjikën e vet, atij do t'i përkiste kjo moshë. A dini se? Dyzeta thuhej ishte mosha e pikëpyetjeve. Aty ndodhnin të papriturat, befasueset, trokitjet në ndërgjegje, tronditjet, zgjimi i pluhurave të vjetëve të kaluar. A kuptoni, pra? Mangësitë e njëzet vjetëve të parë, grumbulluar tek e dyta, burrin e detyronte të bënte një hap pas. Dhe, në vend që të hidhte edhe një hap më përpara, ndalonte e vështronte ç'i kish mbetur nga e kaluara. E hapin e hidhte në vendin bosh. Të tjerat, të kuptueshme: qorrollisej, rrëzohej, gjakohej e thyente këmbë, çapokë, hundë a buzë. Kishin ngjarë këto te cilido e te gjithkush. Andaj, njerëzit me mend, patën nënvizuar se, në dyzet vjet, mashkulli quhej burrë. Gjithnjë duke kaluar këtë cak, sepse aty ndaheshin burrat, burrecët, mistrecët, kastravecët, karkalecat, qaramanët, laramanët (burrë-grua), derdimenët, delenxhinjtë, dënglaxhinjtë, sharrëxhinjtë, gomerët, pykët, rripat, qypat, maskarenjtë, zagarët, kurvarët, imoralët, rrufjanët, servilët, xerxebilët, spiunët, majmunët, fraunët, hajduti, muti, malukatë e baltë.

Gjon Dorani qëndronte në vijë kufiri. Kish të vetat, edhe ky: spërklat e ujit të rrjedhur...

Posa mbaroi gjimnazin e qytetit me nota të shkëlqyera, të riun sykaltër e prisnin rrugë të reja. I ati, burrë me emër të mirë, një oficer lufte, dalë në pension, e cyti të birin që edhe ky të vazhdonte rrugën e të atit. E thënë, e bërë! Familja sytë i drejtoi te perspektiva e tij. Dhe ai nuk i zhgënjeu: mbaroi shkollën ushtarake në kryeqytet, u diplomua si student i shkëlqyer. U ra kufijve kryq e tërthor, gjithnjë me përkushtim dhe la emër të denjë. Pas vdekjes së të atit, nuk di ç'mendje i erdhi, e la detyrën ushtarake e u hodh me Rendin. Si e qysh, përfundoi oficer drejtimi në shtëpitë e vuajtjes në qytetin e lindjes. E, kur përballej me të në ndonjë kafene, ky shprehte kënaqësinë e këtij përfundimi. Natyrisht, i martuar, me shtëpi e grua që përshtateshin, makina lustër, me të ardhura të mjaftueshme, me shoqëri të rangut e me perspektivë të një kufiri normal, as i pari e as i fundit i qytetit.

- Mirëmëngjesi, Gjoni! - zëri i burrit e goditi përbri nga veshi i majtë. Dhe iu duk se çapet e folësit prenë apo humbën në të kundër të tij.

- Përsëndetje! - iu gjegj nëpër dhëmbë ky. Dhe s'e ngau më tej. Ashtu si ishte, në atë gjendje përhumbeje, i pëlqente vetmia. Duke bërë autopsinë e ndërgegjes, ngadalësisht zbulonte gjurmë të vakëta të një kujtese të ftohtë, teksa pranonte se nuk ishte më ai që pati qenë. Tashmë, një i papunë që i rëndonte shpinës së përslagur të bulevardit të qytetit. Dhe bënte arsyetimin

e prapë: ata që vraponin për ndonjë punë, çfarëdolloj qoftë ajo, të tjerë që nxitonin për një takim me ndokënd, ata që shëtisnin për *weekend*, madje edhe dashnorët për te të dashurat e tyre, pa përmendur nxënësit e shkollave, studentët po e po, kalamajtë, gjithëfarët nuk i rëndonin tokës, kurrëjo. Të tjerët, të kallëpit të tij, i rëndonin tokës dhe qiellit, qytetit që zëzinte, gjallohej, turbullohej, kthjellohej sërish, gjer në humbëtimë makutërie. Edhe deti njerëzor, ndërtuar prej të njëjtave ligje, si natyra në gjithësi, po ashtu. Ndërsa shëmbëlltyrat e vetes qenë, pak a shumë, mbeturinat e anës së detit.

Ndërkaq mëniu shturshëm: “Ptu, dreqi ta hajë! Në errëtajë t’i humbasë shpirti atij që u bë shkas!” - ktheu po aty: “Ore, t’u mbylltë, tani je njeriu i mbytur në gjiun e ligatinës”... Për më tej provoi ta quante veten “helaq”... Do të qeshin njerëzit ca kohë mendoi, pastaj do t’u mësohet veshi, syri, goja, mendja, ndërgjegjja njerëzore (ligji i përshtatjes). Kur e kur, ky njeri me emrin real, në moshën e kontrastit të gjithkahshëm duke ecur me hapat zvarrë, maste gjatësinë e rrugëve, shëtitores, bulevardit të qytetit, numëronte dyqanet, kafenetë, baret, madje edhe ballkonet e pallateve... Kujtoi se dikur i pati ndodhur edhe një budallallëk i tillë: pati zënë një qoshkë në bigaçe të rrugës me palma. Mëngjes herët qe si i tilli, por diç më freskët. Ai filloi të numëronte kalimtarët, një e një deri në iks

numër. Ndërsa i ngatërroi nga përzierjet, hyrje-dalje, filloi sërish nga e para, me mendim të përqendruar, vetëm hyrjet. Edhe ashtu, prapë gaboi. Lojë qesharake apo jo, i thoshte po vetes, sepse ishte vërtet një lojë e tmerrshme. Dhe, mbase do të kishte vazhduar gjatë, ndoshta deri në çmenduri, pse ujëra të tilla, që rridhnin prej shpirtrash njerëzore të vrerosura, derdheshin në ata përrenj. Dhe ai prill, vërtet për të, do të qe prill i zi, i thyer, i krisur, prilli i vrarë, prilli i çmendur. Veç që aty, në atë pozicion të gjekëtirë të hiçmosgjësë, rrezatoi një risk dielli, i cili i depërtoi që brenda shpirtit. Dhe ablagimit i dha tjetër cytje: po kalonte mu pranë fytyrës së tij kamerierja ezmerkë. Diç e përngacmoi ajo. Dhe u zhduk me hapa të shpejtë për në barin ku e prisnin klientët, apo pronari nervoz.

Atëherë i papuni i thirri mendjes, duke kuptuar se s'ishte i vetëm mbi këtë tokë. Dhe, s'ë kishin lënë as fuqitë fizike, as forca e mendjes. E bëri veten për djalë, ende i vlonin ndjenja të tërbimta përbrenda. Iu qep asaj si një herë e një kohë. I tha vetes se ndjenjat e sillnin në jetë: lufta, përballimi, përtëritja... Tekembramja, të provonte, do të thoshte të vërtetonte ekzistencën e vetvetes. Dhe, po aty, apeloj po brenda qenies: kishte një parandjenjë dreqi se i burgosuri, për shkakun e të cilit e nxorën në lirim, jetonte në qytet, apo ndër rrethina, për arsye taktike... Ndërsa ky: i papunë, i pashpresë, i përbuzur... Po, ndërçast, pas asaj

përshëndetjeje me baristen brune, harroi mendimin e parë e mori tjetër vendim: do ta gjurmonte atë femër, do ta përndiqte deri në një ditë, në një çast a gjer në vdekje. Atëherë... E ç'rëndësi kishte, në qoftë se nuk do ta thërrisnin "Gjon Dorani", pa emër nuk do ta linin... Tekembramja, nuk do të trokisnin në ndërgjegjen e tij ulërimat e pavijonit çmendurak e ai të mbetej thjesht një rrugor i pacak.

Ha-ha-ha, qeshi: arsyetim vetmak, i cunguar, pa nerv filozofie. Dhe shtoi se për njerëzit e vegjël bota ishte e madhe dhe e vogël njëkohësisht. Ajo rrotullohej, shtillej, mblidhej si lëmsh, si iriqi i mveshur prej asaj lëkure të trashë gjithë gjemba, për të mbrojtur ato pak kile mishi e një dorë kockash, duke u tërhequr frikshëm, rrokullisur, ngjeshur brenda vetes për t'u ruajtur nga agjentët e jashtëm. Paçka, Gjonin e rremetisur e rëndonin të tjera halle... Ndër mend bëri lojën e majmunit: u hodh nga njëra degë e pemës në tjetrën, ose nga pema në pemë... Dhe u rrëzua, e u bë thjesht një kufomë, brenda kafkës mbetur vetëm me pak tru: të mundte të gjente atë njeri që ia hëngri kokën. Do t'ia ngrinte lakun e do ta kapte si miu. Pastaj do t'ua shpinte atyre të ministrisë, do t'ua lëshonte mu përpara fytyrës: na, mos merrni në qafë njerëz të pafajshëm! Atëherë, ministri a kryeministri do të nxirrnin nga sirtarët dosjen e tij dhe do të mendojnë ndryshe. Ndërkohë:

- Do të të bëj përshesh, o bir kurve! - nga një automobil i zi, doli britma e një njeriu. Ndodhi aq pranë, sa dava centimetrash ndanin nga rrotat e makinës.

- Ç'kërkon prej meje, ore qen i zgjebosur?! - klithi vetmaku i hallakatur, i tronditur ndërçast.

Kur ngriti sytë, vuri re se automobili humbi në kthesën e fundit. Fiksoi, aty për aty: qe një makinë e zezë, vetëm kaq. U shty prapa dhe u mbështet për trungun e palmës së vjetër. Nga gjurmët e provokatorit në vetëdijen e tij i kishin mbetur shumë pak, për të mos thënë zero, timbri i zërit, i cili s'dinte si i qe futur brenda trurit, ishte ai topthi i zi me gjemba iriqi, i cili qe rrëzuar deri atje. Atë timbër zëri e kishte njohur... Dreqi ta hante ishte turbulluar i tëri. Trupi i dridhej. Të kthej në shtëpi të qetohej? Jo, qe larguar prej shtëpie i sherrosur. Tekembramja, mendoj, mund të ishte më mirë të çapte drejt e te bari i ezmerkës, për edhe ku qe nisur. Tashmë, treni kishte dalë nga shinat: i sëmuri ecte për inerci. Ajo (ezmerka) e pati afruar disi, tha: "Kush shuan zjarrminë e një femre, shuan llavën e ndezur të një vullkani, o Gjon Dorani", - duke i dhënë kurajë budallallëkut të çastit. Në të vërtetë, pas çkabëmave, që e kishin sjellë në këtë pikë, kuptonte se nuk ishte ai që kishte qenë, pra nuk qe më për shtëpinë e as për syrin e shoqërisë që, njëherë e një kohë, e çmonin karakterin e tij. Në jetën e së tashmes

vlonte, si një rrymë e keqe, zjarri hakmarrës... Jeta, që po bënte, ia kishte hequr trutë. Retë e shiut, të cilat u shpifën në çast, po i derdhnin mbi kokë e mbi trupin e tij, me fishkëllima litarësh, ca mace të ngordhura. Ndoshta, shumë... Po mbytej vendi me kërma të qelbura. Gjon Dorani bënte durim.

Edhe dikush tjetër i kishte parë ato macet e ngordhura, lëshuar nga kupola qiellore së bashku me ata litarë shiu, duke mbushur rrugët e sokakët e qytetit dhe, pa diskutim, gjasa merrej e vërtetë.

Po ky “dikushi” së kishte hallin si shëtitësi i pafat, ohu, ku nata e ku dita. Se, tekefundit, ky s’kishte as emër: njerëz të ndryshëm e ndillnin me nja katërmbëdhjetë emra a përmbi. Kot të tëra, asnjëri s’ ishte i tiji, emri i vërtetë i kishte vdekur atë mëngjes dimri me erë e mjegull, teksa bëri arratisjen nga shtëpia e vuajtjes, së bashku me dy shokët e armëve, iu vra edhe emri. Shumë-shumë mund të ndodhej në një dosje atje, në ndonjë sirtar të ndryshkur. Kjo pak rëndësi kishte. Ose..., ose, nga tërësia e emrave të stisur, atij edhe mund t’i kujtohej mend vetëm një, fjala vjen emri “Zejdin Brinja”. Më e keqja s’ ishte puna e emrit, po diçka tjetër më e madhe, më e trishtë, e mundimshme gjer në shpirt: ai kishte humbur sensin njerëzor.

Ishte kërbishtur si qen, i përbuzur, i lektisur. Pati zbritur nga një fshat i humbur i Grykëzit, nga një krahinë të krisurish e në një qytet të çmendurish. Kudo, i përndjekur. Atje në fshat derën ia patën zënë me drizë, çdo syresh, posa ta shikonte, ta pikaste, do të njoftonte menjëherë diku se ashtu e kështu... Në kërthizë të krahinës qenë ngritur pika komande të policisë, ku s'linin mjet pa kontrolluar, madje edhe kafshët a udhëtarët radhiko, gjer te gomerët e ngarkuar me thasë rëre. Çdo njeri e kontrollonin si motmoti. Edhe. Edhe. Edhe... Në çdo kohë, ku të mundnin, një pikë kontrolli, një pikë dhembjeje, një mal ankthi. Policia në qytet kishte vendosur disa lloje aparatesh, që fotografonin në çast edhe zogjtë në fluturim.

Të tre lirirrembyerit i lëshuan në birucë si sende pa vlerë, thuaj si tre ujë të zënë në lak. Dhe të munduar keq, aq sa mund të mendonin se vdekja po u trokiste atje ku buronte e stërpikëj shpirti. Ata e mendonin fort mirë njeriun që i kishte spiunuar, pa përmendur avokatin Çedon Saraji. Por, gjene, mendonte Zejdini, koha dhe njeriu, përmes të cilave zgjatej e zgjatej pa mbarim zinxhiri i jetës, ndërlihdeshin me unaza gjaku, kllapuar ndaj njëra-tjetrës me një simetri të rregullt, deri në përsosmëri. E, ata tre njerëz, viktimat e rrezikshmërisë, mbryjtur e gatuar me ide të mbrapshta, u rrasën një natë dimri në shtëpinë e vuajtjes. Do të lëngonin deri në një, gjersa t'u vinte,

me çapet e tmerrta, vetë vdekja e t'i miklonte me hiret e saj farmak. Fundja, të bëhej ç' ishte nisur për t'u bërë. Ata, pasi e rimorën pak veten, teksa plagët hëngrën njëra-tjetrën; porsi zgjebja në trup, i thirrën mendjes sakaq:

- Ne nuk duhet të vdesim!

- Nuk!

- Por duhet!...

I pari i tyre i rrëmbeu të vetët brenda vështrimit gapërr, si rrëmbimi i tërbim të flakës së një kamine në gojën e porsahapur. Zjarri ishte brenda shpirtit përvëlak: i digjte, përlante gjithçka, mbase asgjësinë e pacakë, e cila përcaktohej nga të tjera rrethana. Po i pari i tyre kishte pranë të dy shokët e armëve, të qëllimit, besës, të përkushtuar, ose njëri më ujk se tjetri. Tashmë, mbetur të rrënuar përdhe, gjer në ronitjen e mjerë, pa kurrfarë shpresë.

- Ç'të bëjmë? Edhe luani në kafaz s'bën asgjë më tepër përveç hungëritjes, i dyti, flokëngritur si gjëmbat e lëkurës së iriqit. Trishtimi, që e pati pushtuar, iu shndërrua në çast në një egërsi tmerrri.

- Vërtet, edhe duarkryq s'duhet ndenjur, diçka duhet bërë, nëse mundet, -tha i treti, i mendueshëm, fjalëpakë e shpërthyes njëkohësisht.

- Ne nuk duhet ta presim vdekjen me patkonjtë përperjetë, - shkumbëzoi sërish i pari.

- Veçse të ulërijmë, që të ngjallim datë e tmerr?

- Qepe! Frikamani vdes nga hija e vetvetes!
- Ulu dhe ti! Së paku të mbajmë njëri-tjetrin, mjaft që mbetëm tre: një favor për ne...
- Diçka duhet të bëjmë, kuptoni?
- Kush ka gjë në torbë ta zbrazë!
- Të sfidojmë vdekjen!
- Një fjalë goje!...
- Jemi të gjallë, çka duhet më tepër?
- Ta gjejmë një mundësi!

U grindën midis. Ranë në qeti e u sherrosën prapë. Kaluan sosh orë, ditë e net e prapë, gjer një moment ku dukej se uji, pas turbullimit, binte në qeti. Në të vërtetë të tre të dënuarit pa kusht, ranë në një mendje. Bënë një plan, dy, tre, disa...

Dhe u gjend një natë favori: natë dimri me shqotë dhe acar në kampin përbuzë detit me dallgë, të cilat zhaurinin tërbimshëm, kafshonin rërën dhe telat gjithashtu. Dridhej kampi në rrokopujë, trandej gjithçka, retë kullonin gjasa pa formë. Binin mbi tokë ca forma gjallesash të përçudnuara që të ngjethnin, të kallnin frikë. U prit pikërisht kjo natë tërbimtare e një tmerrie të pacak. Një *Benz* i zi, pa drita rrëshqiste baltovinave, pllauritur gropave-varr, duke u afruar aq mundimshëm e po aq përvjedhurazi kampit të kriminelëve. Pikërisht në këtë natë, ndoshta ora dy a përmbi, sipas marrëveshjes...

Mjeranët ia shtrënguan duart njëri-tjetrit, bënë rrëmbimthi përpara. Dhe përdorën gjithë manovrat, mënyrat, lajkat, dredhitë, cigaret, dorën në qafë, ujët në rrogos, mjaltin dhe helmin, furçën, thikën, gjithçka, për atë moment, për një qëllim, prova e të cilit luhej vetëm një herë. Dhe, mrekullisht, u nis jo keq: hapën derën e parë, të dytën, të tretën... U derdhën në platformën e betontë tre trupa të gjetktisë në katahumb. Ndërsa rrebeshi qëllonte me kamxhik, nga kupola nxijane derdhte përmbi jo mace të ngordhura, por gjarpërinj hakërrimtarë, të cilët i goditnin për vdekje. Në detin e tollovitur një sirenë anijeje ulërinte në klithë tmerri. Dhe ata u ulën rrëzë murit të lartë, hipën mbi njëri-tjetrin; i pari u hodh mbi telin e gardhuar, po vetëtiu atë çast, lepitka e dritërisë vetëtimtare lëpiu përqarkun tmerrisht gjer në skutat më të imëta. Atëbotë, vetëm atë grimë herë, u kollit një automatik me breshëri të përsëritura... Ndërsa të tre, përvjedhurazi, po i kacavareshin gardhimit me gjemba. Pas kësaj, liria e aq pritur... Dhe tersi po aty. Mbrojtësit e kështjellës së vdekjes vunë korrentin në tel. Kaq ishte: sa hap e mbyll sytë, dy trupa u skeletuan. U skuqën, u nxinë, u hirëzuan. Vetëm kaq, vdekja paskësh ngërdheshur e qenka sulur sakaq nga telat e gardhuar.

Dy figurina të zeza dolën sakaq prej *Benz*-it të zi, e rrasën brenda të hutuarin dhe morën udhën e gjektisë.

Fati... Ai ekzistonte jashtë, pavarësisht njeriu... Asish, hodhi këmbë në tokë i zhburosuri Zejdin Brinja, emërvrari. Për të hije e dyshimit që e gjithkahshme, atje në shtëpinë e vuajtjes, nga ku u dhanë dhe u përhapën informacione të ndryshme: të befta, të tmerrta e të pabesueshme, aq sa njëra binte ndesh me atë çka ishte folur më parë apo ç'kishte shprehur aksh gardian, detektiv tek akëcila gazetë. E gjithë dyshesa binte kah i treti, pse dy skelete mbeteshin kuptueshëm... I treti, mund të që hirësuar, mund edhe të kishte avulluar. Andaj u la hapur çështja. Se të ishte gjallë, hakmarrja do të që e përbimtë. Dhe e pashembullt.

Ndërkohë në Ministrinë e Rendit ndodhi rrokopujë e gjithkahshme, kosa e reformës, e cila korri të fajshëm e të pafajshëm, të mençur e të marrë, debilë a specialistë, butakë a kokëfortë, korrektë a liberalë të pamatë. Asisoj, e pësoi edhe njëfarë oficeri i drejtimit, tashmë shëtitör i pafat, Gjon Dorani. Pa lëre, thoshin, në dreq të shkonte, puna qëndronte te njeriu pa emër a me pseudonime të çuditshme; ai ishte pajtuar vetiu me vdekjen e vetvetes, emërvdekuri... Dhe, a e di se, ai i gëzohej këtij fakti. Qysh herët ia kishte qejfi t'i thërrisnin me pseudonim, çka e përdorte rrallë, edhe kjo rrjedhojë po ecte ende në të përditshmen. Frika e rikapjes po e ndiqte hap pas hapi. Për të vetmen arsye, sepse ai nuk qëndronte mbyllur, por dhe as duarkryq. I shfaqeshin, herë pas here, fytyrat e shokëve të

burgosur, që ngërdheshnin, qanin, qurrajepshin, sikletoseshin deri në zero. Ose shpesh, ankthohej për një hakmarrje të tërbimtë karshi atyre që i rrasën brenda... Avokati, hëm! Dhe ishte i prerë kur thoshte se kush të shpëtonte gjallë, do të hakmerrej për të tre. Qe i bindur te vetvetja: Zejdin Brinjës nuk ia hante qeni shkopin...

Kështu iu desh, jo pak kohë, të merrej me fytyrën e atij spiunit, të cilit ia patën bërë benë. U përplas me të një ditë, e ftoi të hipte në *Benz*-in e zi e, po aty, i lau hesapet shpejt. Po, tamam, duhej të pranonte se bëri punë të paqme... E mbyti me kravatën që mbante lidhur në qafë. E rrëzoi në oborrin e shtëpisë së vet: kaq mbaroi filmi. Ndoqi ndërkohë lajmet televizive për të vjelë opinionin. Thujse, mbeti kënaqshëm për aludimin e pacak. Ose, ose, ndërsa përflitej ndër kafene se burrin e pati mbytur gruaja e vet për atë a këtë hamendësim, apo dikush i tretë, punë femre me një fjalë, ishte një ogur i mirë për fshehjen e gjurmëve të të vërtetit. “Hë, pra, mirë mbaroi ajo punë”, - i belbëzonte vetes, hera-herazi, teksa në tjetër rast mendonte gojëkyçur e zemërderr. Tershi ishte gjetiu. Ata të përtejdetit ngulmonin që ky të soste punë në kohë e të largohej sa më parë nga vendndodhja. Çdo vonesë pa bereqet sillte pasoja të shkatërrimit të grupit, që do të qe katastrofike e do të rëndonte mbi të pesha e fajësisë.

Ca nga halli e ca nga malli, siç i thoshin, ose ca nga tmerri i frikës, ca nga trysnia e përbirimit të gjithkahësisë, ai bënte përpjekje ta bindte veten, për t'u shkëputur vërtet prej këtej. Por, befas, i dilte diçka që e gozhdonte në vend. Kohëvonë, i ra në tru çështja e avokatit, të cilit ia patën bërë benë qyshkur, teksa dergjeshin shpresëthyer ndër qelitë tërë lagështirë. Pa pikë mëdyshje, duhej bërë... Dhe, prapë e kthente pllakën sapo vendoste tjetër send: të hiqte qafe hetuesin së pari, pastaj avokatin, të cilit i pati rënë në gjurmë. Mirëpo ia ndërruan planin ata që komandonin, pra. Për më tepër, avokati i doli në shteg. Zejdin Brinja e peshkoi mirë e mirë, e futi gjorianin në *Benz*-in e zi, pastaj lulen mu në lule të ballit. Ah, jo tamam, mendoj, ai s'duhej të kishte fatin e të parit. Mjaft, të zhdukej, për t'u marrë paskëtaj me të shoqen, atë pelën hallate, a të bijën. Kështu: ia lidhi të dyja duart, e nxori nga qyteti ndaj natë, preu në shkretëtirën e pishnajës kah buzëdeti. Ndaloj diku, e qiti jashtë dhe e lidhi për bishtin e automobilit, pastaj në vrullimë...

Nuk vuri re se sa eci, frenoi një çast, zbriti. Në vendin ku qe lidhur trupi kishte mbetur njëri krah, me gishtërinjtë e gjakuar, që dukeshin se lëviznin ende. Eci ndoca më këmbë, gjersa u përplas me trupin e gjymtuar të avokatit. Përreth ndodheshin një grumbull pishash të buta dhe kishte rërë, vetëm rërë. I ra në kokë tjetër aventurë, hapi një gropë dosido mbi

rërë. Dhe ia mbuloi trupin si t'i vinte kapak kësisoj kufomës së avokatit Çedon Saraji. Dhe ishte i bindur se ajo qe një vrasje e rrallë. Dhe e merituar. I mbeti kohë për t'u marrë edhe me femrat. Së paku, me të bijën, e cila vazhdonte shkollën Pedagogjike. Kur t'i vinte këto punë në vijë, do të degdisesh përtej kufijve. I mendonte asish, porsa kthehej për tek automobili. Ndërkohë, e papritura e pakënd ngjau po aty: dora e viktimës ishte gjekëtitirë.

Zejdin Brinja u vu në siklet: mos, ndoshta të qe ndodhur njeri aty kund? Ky do të qe kulmi, një tmerr i paparë dhe e pa mundur kurrë për një vrasës profesionist. Pa plus-minuse do të mendonte se kishte rënë në grackë. Po aty e pushtoi një ankth që s'kishte e s'mbante kufi qetimi. Ia dha vrapit në humbëtim, ndërroi bazë e mori masat për një mbrojtje hermetike. Madje çngjyrosi flokët, ndërroi veshje, mënyrën e sjelljes, pseudonimin po se po, s'la grimë për pikë dyshimi. E, asish, kaluan ditë, kur, sapo zbriti te bari, atje te *Rruga e Palmave*, mësoi këtë të vërtetë: kohë më parë kishte kaluar mes për mes qytetit një qen stani me një dorë njeriu në gojë... Thasha kishte marrë arratinë e nuk dihej sa e mirëqenë qenkej ngjarja. Mandej, përziheshin ujërat e përrenjve, gjithsesi. E qenkësh hapur fjalë se pati humbur një njeri, dikush thoshte se njeriu humban qe rrëmbyer... E dëftonin se zezani s'ishte njeri sido, na qenkej një zyrtar, njeri publik. Gjasat qenë shpërbërë e gjekëtitirë në rrëmujën e katahumbit. Të vërtetat, jo vetëm që nuk dilyn në shesh, por njëra ishte më befasese e

më tmerruese se tjetra. Zejdini i dëgjonte me veshët bigë, reagonte kujdesshëm e nënvizonte brenda trurit çka i interesonte atij, gjersa ngjarjen do ta mbulonte pluhuri i harresës. Të tjera do të dilyn më të çuditshme e përbiruese gjer në palcë. Përfshi, asisoj, rrëmujën e reformës në Ministrinë e Rendit, mandej gjurmimi i gruas vejane... Miopia e atyre lart... Rendja në mjegullnajë dhe degdisja e oficerit të drejtimit...

Tash e prapa, ndërsa u kapërcye heshtazi caku, Zejdin Brinja u lidh me grupin përtej detit, u tha se punët shkonin ende mirë: do të mbaronte edhe ca bishtra cigaresh për të vajtur haku tek i zoti. Mirë këshilli, thoshte, punët ecnin paq, deri në ditën e prillit të theqafes, kur sytë e Zejdinit pikasën një njeri. Duhej të qe ish-oficeri i drejtimit..., ai tip delenxhiu dhe askush tjetër. Por i duhej të përballej, të lidhej fjala. Ai duke u ndodhur i papunë, dhe i nxjerrë në lirim, si i padenjë, mund të bëhej një pikë mbështetjeje... Tekembramja, ai kishte jo më pak llogari se dy të parët, tashmë harruar. Dhe e ndoqi qëllimisht me *Benz-in* e zi, thjesht për ta njohur mirë. Dhe për ta provokuar, sigurisht. Sikur po e këndellte një epsh për një pritmëri solide. Sido që, një mendim i bukur, sikur po i këndonte në vesh. Tashmë, që pati depërtuar në të brendshmet e gruas vejane, s'para ia kishte dhe aq qejfi t'i përlyente duart në gjak. Gjene. Gjene. Gjene... E shoqja e Çedon Sarajit kishte filluar sërish punë në barin e dikurshëm. I tha brendësisë trazimtare: "Jepi, Zejdin Brinja!".

Zdërhalla e braktisjes, Gjon Doranin e kishte vënë nën këmbë, madje edhe përçartja familjare, gjithashtu. Pra, ishte më i padituri për çka i përkiste gjurmëve të kriminelit të arratisur, thjesht dyshonte se në qytet luhej diçka e keqe dhe ankthi i zhdukjes së avokatit, Çedon Saraji, qe bërë i pranishëm për të, por prapë ndihej i pafuqishëm. Kur e kur, ishte interesante të kuptoje, aq më tepër të zbërtheje të brendshmet, idetë, planet, kurthet dhe të zezat e një krimineli, i cili e pranonte intrigën si një vepër krenarie. Kësisoj e vërenin Zejdin Brinjën bashkëkohorët, ata që ia njihnin portretin kur e ndiqnin rruginave, të kreshtuar e befasuar po aq. Ndërsa ai vazhdonte të bluante ndër dhëmbë: “Çedon Saraji... Çedon... Çe...”.

Mbase, asisoj vrastari bënte mërmërimën e dallgëve në pragshqotë. Ai edhe mund t'i kërkonte dikujt shpagë, ashtu si mund edhe të shpaguante për dikë. Gjithaq, edhe nëse dilte thelbësorja në sipërfaqe, çka mund të qe edhe më keq, Zejdini i besonte vetes dhe ndiente kënaqësi çasti. Të shijojë një hidhësi, duke

vrarë jetën, me a pa shkak, apo për hatër të çeleqejit, qe akti më zezan i kohës në Qytetin e Trazirave. E, asish, ngjézimi, që ishte lidhja afërore, ose ylli i njeriut, tretej në gjekëti, në hirin e pamat, humbte të qenët esencial, pa ardhur radha që askush të arrinte të bënte klasifikimin: ky është njeri i mirë, i keq a palo... Ose, ose: ndoshta ndokujt i pati prurë rasti të gëlltiste mjaltë të hidhur. Thoshin që bleta e gatuate këtë lloj mjalti nga varësia e kullotës, pra mund të qe një kullotë rigoni, cfakë, bedunicë a mare, ku bleta e thëthinte ushqimin e, në përpunim, së bashku me mjaltin, derdhte edhe helmin, i cili ishte po aq i nevojshëm e i dëshirueshëm prej njeriut.

Të kujtonte pikërisht këtë qenësia e baristes ezmerkë, punësuar në një bar rruge, Lira, vejania e avokatit të zhdukur motmotesh. Ashtu siç ishte, shumëkush do ta cilësonte se Lira në vetvete përmbante një brishtësi në kuprin e tejskajshëm. E gjitha, nuk kishte të bënte për një bukuri perle, kurrëjo, por diçka tjetër, diçka të pakapshme gjer në dëliri, duke pranuar gjithsesi se bëhej fjalë për një vejane, pavarësisht hamendësimeve të gjithfarëllojshme, të përsëritura në kohë, mjedise të ndryshme a nga njerëz që përfaqësonin institucione të kohës. Puna e avokatit pati marrë fund katërçipërisht, mbase në shkallën e monstruoze të gjer në përfund. Pati qenë ky fati i tij, i vajzës shkollare dhe vejanes, mbetur në bigaçe të cakt, por gjithsesi të vërtetat lundronin në mjegull.

Për të ngulur një piketë, atje në varrezat e qytetit, ajo sajoi një fantazi marrie. Në një vazo me lule, punim guri me gdhendje, shkroi një trajtë epitafi mu në përfaqe: “Çedon Saraji. Kujtim nga gruaja dhe vajza”. E vendosi vazon me epitaf në një varrezë bosh. Kaq. Në ditë të shënuara, si shumëkush, kalonte atje së bashku me vajzën, kryente ritin e kthehej sërish në jetën normale. E ky qëndrim i vejanes ngjalli kureshti e thashethemnajtë në qytet. Gjithsesi, ajo jetonte brenda pikëpamjeve të veta, me ndershmëri sa te Zoti e përkushtim për mirërritjen e vajzës. Dhe shumica e syveshëve, kur e veneronin, duke i mërmëritur dikujt, dëftonin se vejania ecte në rrugën e ndershmërisë, pra kthehej opinionin alltys, bëheshin mbështetje, mbrojtëse të gjithçkaje e për çdo gjë. Lira vërehej se e pati fituar këtë eksperiencë, duke shënuar në ecje karakterin e denjë të femrës vejane.

Gjithaq, jo dëndurherë, asaj punët e jetës i shkonin vaj, aq më tepër rasti i freskët... Ajo ishte si trasta në degë: shkonin e vinin erërat e kohës, e tollovisnin atë sipas rrymave të ndërsjella, e shkundnin, e rrihnin, e leqendisnin gjer në shformim. E, ndodhte kjo, kur në rrugë, qysh herët, i shfaqej dreqi... Thoshin se ai paskësh trembëdhjetë këmbë. E, nëse ia thyenin një rën, paskësh mjaft aftësi të një shumëzimi të tërbimtë dhe atëherë dreqi bëhej aq i prapë e aq i egër, sa s’e merrje me mend; haj medet aso çastesh!

Që të ishte e hapur, ajo do të pranonte çeltas se, qysh herët, para humbjes së të shoqit, i pati dalë

në udhëkryq i trembëdhjeti me të tëra prapësitë e tmerret që kishte hequr deri në vazhdë. Ishte ky, djalë apo burrë, njëfarësoj, aty rreth të dyzetave, trup mesatar, veshur me kostum xhins, herë pantallona xhins-blu me këmishë duarshkurtër me kuadrate. Thoshe, asisoj, trup i mbajtur, gati muskolor, ngjyra e fytyrës bojëgruri në të murrinë, sy të zinj, të mëdhenj, vështimegër, me një dukje krejt të prerë, me nofull të hedhur, që binte në sy në vështimet jo të zakonata. Flokët të zinj, çapraz. Dhe vetullat gjithashtu të zeza, të ngritura përpjetë si nga një pinellë bojërash a si një krah zogu në vrullim. Ky tip që bërë i zakonit në lokalitë ku shërbente Lira, aq sa dukej si i shtëpisë: pinte kafë, konjak, largohej papritur e, po ashtu, kthehej sërish. Ndoherë ia behte aty edhe me dy tipa të tjerë: njëri qimeverdhë - flokëgjatë, tjetri kokërrjepur, krejt shalqi i pabërë. Pra, atëherë dhe sa herë të tjera, në vend të konjakut, ata merrnin një shishe uiski, gjysmë litërshe dhe e thanin të tërën. Lira i vrojtonte asoherë, pa interes të ngutë. Edhe pse s'vazhdoi kështu, i njëjti rit kaheë.

Kishte ca ditë, ndoshta mestetori, posa nisën shirat e vjeshtës, aty nga mesdreka ky, mashkulli me flokët çapraz, u paraqit fillikatisht, teksa lokali ishte bosh. Dhe zuri një tavolinë në një kënd e i foli asaj, që t'i çonte kafënë me një dopio konjak. Lira e qetë, veshur me përparësen e bardhë borë, iu paraqit me mirësjelljen

e zakonitë, e ia uli porosinë mbi syprinën e tavolinës: filxhanin me kafë dhe konjakun, duke ia shoqëruar edhe me një buzëqeshje, thjesht gjest femëror. Ndoshta ajo që afruar paksa në mirëbesim. Kur e kur, tipi klient, Zejdin Brinja, me një lëvizje krejt të beftë a tepër të stërvitur, ia afroi fytyrën, me nofullën e përhedhur, thua jse si e një kafshe grabitqare, gati të gjinjtë e saj paksa të dukshëm.

- Ç'po bën?! - klithi në histeri ajo, e beftuar, e ngrirë, gati e marramendte.

- Lira! - shqiptoi tjetri me zërin gati lutës dhe të egër njëkohësisht. - Unë pas teje marrohem!

- Unë jam grua e martuar, zotëri! - e mori veten, porsa ajo.

- E marr me mend. Po, a e di?!

- Çfarë?

- Se ti ke një erë të marrë, një erë të mrekullueshme prej femre. Dhe do të bëhesh e imja!...

Desh t'i përgjigjej ajo e t'i thoshte, o i çmendur, unë jam zonja e avokatit Çedon Saraji... Por nuk u bë e mundur: aso çastesh hyri një grup njerëzish zëratrazuar; si dukej bëhej ndonjë fejesë nuseje. Erdhën gjithë zhurmë ata, bashkuan tri-katër tavolina e dhanë porosi të rrëmujshme. E, Zejdin Brinja, brenda atyre minutave, rrëkëlleu gotën, vrulloi e doli jashtë. E gjitha çka ndodhi midis tyre, ajo e cilësonte, thjesht, një skandal të vogël... Dhe, nuk ia zuri incidentin në

gojë as vetes e as kujt. Po edhe tipi, i rralloi vizitat, pa e shtuar aspak agresivitetin, që e ankthonte kamerieren ezmerkë. Gjer, gati, për disa muaj, ai s'u duk më. Ngjasoi pastaj edhe zhdukja e avokatit dhe ajo, ia harroi trajtat e fytyrës atij tipit asisoj.

Vejanja krrakërone si korbi në kërmë përgjatë udhëtimit të brengës: humbi burrin, humbi jetën... Dhe u nxi. Veshi lëkurën e deles llajë e blegërinte në gjekëti, duke derdhur përrenj malorë nga sytë e saj të zinj. Dhe, së fundmi, rrëketë i thanë burimet në një cak pa kufi. Gjithë-gjithë nga gjemata e humbjes së Çedonit të gjorë, femra-qyqe ra në trishti, duke kërkuar vdekjen në tokë, e kërkonte në det, e kërkonte në qiell, në shpirtin njerëzor e kërkonte... Po, kudo e gjithkund, ia mbyllnin dyert. Dukej se gjithkah i thoshin: mjaft, ti ke jetën tënde, Zoti, në emër të atësisë, të ka lënë vajzën, së cilës duhet t'i përkushtohesh... Mbërriti një moment, kushedi si u ndodh, në katrahamën e netëve zgjyrë, Lira i tha vdekjes: "Më març të keqen! Hajt, pra, i gjalli me të gjallin...". S'ishte e vetme në këtë botë. E, aty për aty, gati në atë orë, kur nata ndahet më dysh, ia bëri një telefonatë pronarit të barit ku punonte. Fatmirësisht. Fatmirësisht... (Nga tragjedia familjare, qe shkëputur nga puna.)

Duhej të ketë qenë ditë e martë, atëherë, kur ajo u paraqit në lokalin e dikurshëm. E, thajse, ndo kohë për Lirën mbërritën ditë urimesh. Dhe, ngadalësisht, buzëqeshja mirëprirëse zuri pozicionin e qëkurshëm.

Lokalit po i ktheheshin klientët, pronari shijonte kënaqësinë. Pas kësaj, kohëvazhda që e zakonshme, me një dyndje në mëngjes, rrallim njerëzish gjatë drekës, përveç ditëfestave, që Lira kthehej e dërmuar në shtëpi. Sosh, gjer atë drekherë të atij shkurti, kur në holl bëri këmbë klienti humban, Zejdin Brinja, mashkulli që gjuante femra. Së paku, kështu mendoi Lira, posa ia dalloj fytyrën paksa rrëgjake, zeshkur cazë më tepër, me nofullat e trasha e me sy vështirëgjer. E njohu baristja dhe, pa i ngritur sytë, përgatiti ekspresin dhe një dopio konjak, siç e përdorte tipi, ia vendosi mbi tavllë, çapiti kujdesshëm drejt qoshkës, ku ai që ulur e thëthinte tym duhani mërzitshëm, gati i nervozuar.

- Porosinë? - u çel i pari ai, i befasuar, duke shfaqur dhembët e ngrënë, paksa të verdhur.

- Si gjithnjë, besoj? - ajo vuri re se klienti, ai trapi i dikurshëm, paskësh lënë edhe një palë mustaqe spic mbi buzët e holla, të cilat asaj iu dukën pa shije.

- Natyrisht, si gjithnjë, - saktësoi ai.

- S'jeni bërë i gjallë ndo kohë, - ngau pa vetëdije ajo.

- Eh, emigracioni! Andrallat e jetës. Po ju?

Lira e kuptoi që po gabonte: ktheu krahët në çast dhe gjeqëti. E, kur u kthye më vonë, klienti i pati rrufitur të tëra, lënë të hollat mbi tavolinë, kishte avulluar.

Atë mbrëmje ajo pati folur me vetvete: qortuar, turpëruar, shkalluar dhe e pati mbytur gjithçkanë

me lot. I paskësh lënë rast një njeriu që s'ia vlente në asnjë pikë. Veç ditët që pasuan s'nxorën ndonjë yçkël. Përkundër, të zakonat. E, ai tipi vinte rrallëherë e qëndronte kokulur, pa më të voglin reagim ndaj saj. Dhe, dimri kërthi, si flitej, po derdhte gjithë mllëfin e grumbulluar ndër kohë. Shirat e shqotat po rrihnin qytetin me kamxhik: dyqanet, qepenat, xhamat e dritareve, rrugët, bulevardi i palmave e shëtitorja në pjacën e qytetit po përballonin një batërdisht të paparë shirash. Era ulërinte mbi qytet dhe deti, përbishte tij, vazhdonte të rënkonte dhembshëm. Vetëtinte në thellësi e qyteti provonte ditë-net pa drita elektrike.

Në një të tillë ditë psherëtimash, ia behu në lokalin e Lirës ai: tipi klient me kapuçin e zi, që e la në kënd. Po aty, në tavolinën karshi dritares, la paketën edhe një çakmak mbi të. I kërkoi baristes të mësonte vendin e tualetit dhe u drejtua për atje. Pas ca doli e i kërkoi ndihmë, se çelësi dukej i bllokuar... Dhe ajo, me mendim të shpërqendruar, pa më të voglin ngurrim, bëri t'ia hapte derën... Atëbotë ngjau e papritura: ai e kapi për kyçin e dorës, e rrsi brenda në banjë. Ia rrëmbeu fytyrën, e puthi, e kafshoi, ia shkopsiti kopsat, ia përzhiti përparësen e bardhë. Dhe Lira ra, u tret si kripa në ujë brenda pak çastesh. Dhe gëlltiti një lugë mjaltë të hidhur. Bënë seks qençe... Zejdin Brinja po gjente vetveten, le të drithërohej qyteti në mjegullinën e gjithçkasë. Tash, mendonte, e kishte